



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 25/2010

Prishtinë, 22. 06. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Fatmir Rexhepi, Mursel Halililji, Adem Grabovci, Sala Berisha – Shala, Kaqusha Jashari, Mufëra Şinik dhe Qamile Morina.

Mungoi: Zef Morina.

Pjesëmarrës të tjerë: Hakif Bajrami(Jashari) dhe Dukagjin Shala – MEM, Remzije Hajdari dhe Mehdi Pllashniku – MTI, Lumnije Murati – ZPR, William Klawonn – USAID, Besim Zeqiri –ICO dhe Besnik Ramadanaj – KDI.

Stafi mbështetës: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Nuriye Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të 15. 06. 2010;
3. Rishqyrtimi i Raportit të Projektligjit për miniera dhe minerale nr. 03/L-163;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, nr. 03/L-210;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 15. 06. 2010

Procesverbali i mbledhjes së 15. 06. 2010 u miratua pa vërejtje

3. Rishqyrtimi i Raportit të Projektligjit për miniera dhe minerale nr. 03/L-163

Kryetarja – Ia dha fjalën kryesues së grupit të punës për Projektligjin për miniera dhe minerale nr. 03/L-163, Sala Berisha – Shala.

Sala Berisha Shala – Theksoi se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka dhënë një sugjerim që Departamenti i Gjeologjisë, që tash për tash është në kuadër të KPMM-së, të rregullohet, sepse ndoshta rastësisht na është përvjedhur ndonjë lëshim gjatë hartimit të raportit. Mendoj që kjo çështje do rregullohet nga MEM, gjatë fazës së ndërtimit të Shërbimit Gjeologjik, përmes konkursit për rekrutimi të këtij stafi , natyrisht KPMM duhet të lirohet nga ky segment që tani veç do behet segment i MEM-it. Gjithashtu edhe Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi i ka dhënë disa vërejtje për amendamentet 53, 62 dhe 63. Këto vërejtje janë me vend, sepse pozitat, në këtë rast e kryeinspektorit dhe ajo e drejtorit, të përzgjidhen nga Komisioni Parlamentar(është në kundërshtim edhe Ligjin për shërbyes civil- emërimet të larta). Sipas amendamentimit bien në kolizion, sepse përzgjedhja në këto institucione është e rregulluar me Rregulloren(për shërbyesit civilë për emërimet të larta. Prandaj ne nuk kemi nevojë të veprojmë ndryshe, se në ligjet në fuqi do të krijohej kolizion. Për ligjet në fuqi në Kosovë kërkoj kemi mirëkuptim me anëtarët e Komisionit dhe të merren parasysh vërejtjet, të cilat i ka dërguar Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kryetarja – Vërejtja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, në nenin i cili e plotëson, thuhet të bartet Shërbimi Gjeologjik i Kosovës. Gjatë hartimit të Raportit mungon një fjali. Kjo i ka krijuar disa dilema, që duhet të mënjanohej nga stafi mbështetës i Komisionit. Vërejtjet e Komisionit për Legjislacion, si amendamentet 53, 62 dhe 63, të diskutohen, të miratohet sot Raporti dhe ky Projektligj të rekomandohet për miratim në seancë plenare.

Sala Berisha Shala – Është e qartë se ç’ka kërkuar Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi. Mendoj se ne komision jemi mjaft të ç’akorduar, sepse ka ide të ndryshme. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka kërkuar që kryeinspektori të zgjidhet në përputhje me ligjet në fuqi, sipas Ligjit për shërbyesit civilë në Kosovë. Ndërsa draftin, të cilin e kemi sjellë në raportin e fundit, thuhet që për kryeinspektorin KPMM-ja të shpallë konkurs, ta bëjë një listë të ngushtë dhe ta sjellë në Komision Parlamentar. Komisioni Parlamentar ta caktojë cili do të jetë kryeinspektor. Kjo është një përzgjedhje *miks*, që

është në kundërshtim me Ligjin për shërbyesit civilë, sepse kryeinspektori është shërbyes civil dhe është zyrtar i lartë. Kështu gjatë fazës amendamentimit, kur e kemi pasur në përpunim këtë draftligj, nuk e kishim në fuqi Ligjin për shërbyesit civilë, po Rregulloren e UNMIK-ut. Ndoshta për këtë hamendeshin anëtarët të Komisionit që të bënim diçka të ligjshme me specifike për këto raste, përderisa nuk kishte ligj në fuqi. Tani e kemi në fuqi Ligjin për shërbyesit civilë dhe për emërimet e larta dhe do të ishte mirë të harmonizohen edhe amendamentet në fjale.

Kaqusha Jashari – Pasi është miratuar Ligji për shërbyesit civilë, jemi të detyruar ta respektojmë. Mendoj se nuk kemi për çka të votojmë, sepse kemi pasur mjaft problem sa i përket zgjedhjes së kryeinspektorit. Ai u takon shërbyesve civilë dhe udhëheqjes. Mënyra e zgjedhjes është sikur për të tjerët, pra nuk duhet të veprohet në kundërshtim me Ligjit për shërbyesit civilë.

Ethem Çeku – Ky Ligj po kalon nëpër shumë peripeci. Jemi duke e politizuar tepër. Ligji nuk është duke u bërë për zhvillimin e vendit dhe siç po shihet se do të marrë më shumë ngjyrimë politike për trajtimin e individëve. Kur kemi folur për Inspektoratin, për çështjen e Institutit ose për atë të Shërbimit Gjeologjik dhe për zgjedhjen e kryeinspektorit, kemi thënë se resurset minerale janë tepër vitale për zhvillimin e vendit. Të bëjmë diçka që është në të mirë të zhvillimit dhe jashtë vijave politike. Për këtë arsye shpeshherë kemi bërë kompromise. Kryeinspektorin e kemi konsideruar njeriun më të vlefshëm për ta kontrolluar çështjen e minierave. Tani pyesim kujt t'i besojmë këtë pozitë kaq të rëndësishme? I Kemi provuar të gjitha solucionet e mundshme. kemi pasur edhe modele të USAID-it për zgjedhjen e inspektorëve. Propozoj që para se ta qesim në votim ta marrim edhe qenë shumë aktiv.

Bill Klawonn - USAID - Sa u përket çështjeve të konfliktit ligjor, në qoftë se Komisioni për Legjislacion thotë se ky Ligj është në kundërshtim me Ligjin për shërbyesit civilë, përgjigja ime do të ishte: Nuk ka problem, është krejtësisht normale që ta kemi një ligj të përgjithshëm, i cili e rregullon emërimin e nëpunësve civilë. Mirëpo për çështjet e minierave e kemi një ligj special ose *lex specialis*, që do të thotë se ligji special ka përparësi ndaj një ligji të përgjithshëm. Ligji për shërbyesit civilë i rregullon këto çështje në mënyrë të përgjithshme, ndërsa Ligji për miniera dhe minerale i rregullon këto çështje në mënyrë specifike, në hollësi. Në Raportin, të cilin e ka miratuar ky Komision në mbledhjen e kaluar, amendamentet që kishin të bënin me Shërbimin Gjeologjik ose me Institutin Gjeologjik të Kosovës, me kryeinspektorin, me emërimin e anëtareve të Bordit të KPMM-së, ishin çështje që janë debatuar gjerë e gjatë dhe në mënyrë të thuktë, para se të miratoheshin ato amendamente. Nuk e di se Komisioni për Legjislacion a e ka kuptuar se ne i kemi përgatitur ato amendamente në atë mënyrë. Gjatë hartimit të amendamenteve, natyrisht ka pasur kompromise. Tani ka përpjekje që të prishen këto kompromise.

Sala Berisha Shala – Në qoftë se dikush e ka zvarritur këtë punë, për të cilën tani kam dilema se ndoshta është zvarritur me qëllim. Kaloi një vit që është bërë leximi i parë i këtij Ligji në Kuvend. E dimë se për dy muaj duhet të amendamentohen P/L, sipas rregullores se punës së Kuvendit. Them se janë bërë zvarritje të qëllimshme, sepse pjesë

e grupit të punës keni qenë edhe ju z. Çeku dhe kryetarja e ka dhënë votën e vet, varësisht cili ka qenë më i zëshëm. Ne i kemi diskutuar këto çështje edhe më herët hollësisht dhe kemi sjellë edhe argumente si duhet të jetë Inspektorati, si duhet të zgjidhet kryeinspektori, por edhe pse duhet të formohet Shërbimi Gjeologjik. Po më duket e tepërt t'i sjellim edhe një herë ato argumente, që janë sjell në bashkëpunim me ekspertë shumë të specializuar në këtë fushe. Duhet t'i kthehem edhe arsytimit të Billit, që e ka dhënë edhe më parë për këtë problematikë. Edhe pse kam respekt të madh për kontributin e tij, mendoj se i ka dhënë përkrahje më të madhe këtij Komisioni, ka qene i një anshëm, sipas një psikologjie nga ana e tij, kah është shumica. Ne nuk kemi nevojë të bëjmë specifikime të këtij Ligj, derisa i kemi ligjet në Kosovë, sepse ndoshta në një të ardhme Inspektorati do të jetë krejtësisht i pavarur, do të jetë një institucion në vete edhe jashtë KPMM-së.

Ethem Çeku – Për këto amendamente, të cilat janë sot këtu në tavolinë, është diskutuar shumë gjatë dhe është marrë provoja e shumë institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për një ligj të qëndrueshëm. Kemi pasur shumë debate si ta bëjmë kryeinspektorin të pavarur, jashtë ndikimeve politike. Forcimin e rolit të inspektorit, sepse ai në fund e ka një përgjegjësi të jashtëzakonshme, siç e ka pasur KPMM-ja. D.m.th. janë prekur çështje shumë të rëndësishme dhe mendoj se kemi punuar të gjithë për të arritur që sa më shpejt të dalë ky Ligj. Çështja e zgjedhjes së kryeinspektorit, e Institutit dhe çështja e Muzeut, duhet të mbeten ashtu siç është arrit kompromisi në diskutim gjatë amendamentimit.

Qamile Morina – E përshëndes punën e madhe të grupit të punës. I kemi dy çështje para vetes për shqyrtim: propozimin e Komisionit Funkcional dhe propozimin e Komisionit për Gjyqësi. E kemi edhe deklarin e këshilltarit të USAID-it, se kjo nuk paraqet disharmoni ndërmjet ligjeve. Shtoi se ka dilema ngase nuk përputhen. Kështu gjithmonë do të ketë mundësi për dykuptimësi dhe për dy interpretime, që në të ardhmen paraqet problem për mënyrën e zbatimit të këtij ligji. Ta se është e mendimit, duke u nisur edhe nga raporti i vitit të kaluar, se Inspektorati i Minierave funksionon dobët. Qëllimi ynë kryesor është të bëjmë këtë shërbim të pavarur.

Fatmir Rexhepi – Ka agjenci në Qeveri që bartësit e tyre kryesorë i zgjedh Kuvendi i Kosovës dhe i raportojnë Kuvendit. Selia e tyre është Qeveria ose ministria përkatëse. Për t'u sqaruar Rexhepi e kërkoi mendimin e ekspertit të USAID-it: A është më mirë që kryeinspektori dhe drejtori i Institutit të zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës?

Kaqusha Jashari – Pasi Inspektorati është pjesë e KPMM-së, a është e arsyeshme që të zgjidhet në Kuvend?

Ethem Çeku – Ideja ka qenë që Inspektorati të bëhet i pavarur. KPMM-ja jep licencë, kurse Inspektorati i mbikëqyrë punët, a bëhen sipas licencës, jo si ART-ja, që vetë jep licencë, vet e kontrollon punën. Do të thotë kemi dashur ta ndajmë në dy pjesë Inspektoratin, si organ kontrolli dhe kemi qenë këmbëngulës, për shkak të rëndësisë së madhe që ka, të zgjidhet nga Kuvendi.

Sala Berisha – Shala - E kemi elaboruar gjatë e ne aspekte të ndryshme këtë çështje

duke i kemi marrë parasysh praktikat e vendeve të rajonit. Tash në Raportin përfundimtar jemi pajtuar të gjithë që KPMM-ja të përbëhet prej disa departamenteve, ndër të cilët është edhe Departamenti i Inspektorati të Minierave, që është në kuadër të KPMM-së. KPMM-ja përbëhet prej Bordit dhe departamenteve të caktuara. Kuvendi e ka zgjedhur Bordin. Ne ia kemi deleguar besimin anëtarëve të Bordit të KPMM-së. Për mua tani është e palogjikshme përsëri të zgjidhet nga Kuvendi një udhëheqës i një segmenti brenda KPMM-së, kjo gjë krijon një lloj paralelizmi, apo „pavarësi brenda pavarësisë se këtij institucioni, do tingëllonte me shumë si anarki. Unë kërkoj ta hedhim në votim propozimet që i ka sjellë Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi. Pajtohem dhe i mbështes vërejtjet, që i ka dhënë ky komision.

Adem Grabovci – Kryeinspektori duhet të ushtrojë një kontroll, që për ne është domosdoshëm, që të mos e lejojë KPMM-në të punojë sipas tekeve të veta dhe të shkatërrohen pasuritë tona. Në mënyrë retroaktive të raportojë për punën e vet para Komisionit për gjashtë muaj ose për tre muaj në perioda të caktuara, sepse si komision për çdo gjë duhet të jemi në rrjedhë. Jam i interesuar të punojmë në përputhje me interesat e vendit tonë. Duhet të shikohet si janë përvojat e të tjerëve dhe si e kanë të rregulluar këtë çështje. Tha se është ihtar i asaj që ky institucion të jetë i pavarur, i pa ndikuar nga politika.

Bill Klawonn - USAID - Çështja e konfliktit ndërmjet ligjeve nuk është problem i ri, por shumëvjeçar. Është një problem që ka ndodhur në shumë vende në histori. Me kalimin e kohës nëpër botë janë krijuar rregulla, të cilat e rregullojnë çështjen e zgjidhjes së konfliktit ndërmjet ligjeve. Me këtë dua të them nëse Ligj për miniera e rregullon në mënyrë specifike një çështje specifike, emërimin e një personi të caktuar, nuk ka kurrfarë argumente as dyshimi se ky ligj ka konflikt me Ligjin për shërbyesit civilë, ka rregulla të interpretimit legjislativ, por këtu nuk nevojiten as rregullat e interpretimit legjislativ, është mjaft e qartë, sepse nuk ka kurrfarë konflikti legjislativ. Ligjet, të cilin ky Komision i ka miratuar, përcaktojnë se KPMM-ja, meqë Inspektorati është departament i KPMM-së, i gjen personat dhe i dërgon emrat në këtë Komision. Komision mandej emëron njërin nga ta. Kjo zgjidhje ka qenë kompromis, që është arritur pas një debati jashtëzakonisht të gjatë.

*Me 2 (dy) vota **për** dhe 6 (gjashtë) **kundër** votuan për ndryshimin e amendamentit 53.*

Sala Berisha – Shala – Kërkoj t’u jepet fjala përfaqësuesve të MEM-it, ta arsyetojnë pse duhet të jetë Shërbimi Gjeologjik e jo Institut Gjeologjik, ose të na e tregojnë dallimin ndërmjet Institutit Gjeologjik dhe Shërbimit Gjeologjik.

Dukagjin Shala - MEM – Të gjithë e dimë se institutet merren me punë shkencore dhe me hulumtime. Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, në këtë rast, ka të bëjë me punë praktike. Ne ende nuk jemi në fazën e hulumtimeve shkencore. Formimi i Shërbimit do të hapte mundësinë për profilizim të ngushtë shkencor në të ardhmen., prandaj faza e parë është formimi i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës e jo i Institutit.

Myzejene Selmani – Është kërkesë e MEM-it që Instituti Gjeologjik i Kosovës të quhet

Shërbimi Gjeologjik i Kosovës.

Bill Klawonn - USAID – Emri nuk është aspak i rëndësishëm, por kompetencat që i ka. Ne i kemi përshkruar ato dhe kemi thënë se Instituti e bën këtë. Sipas mendimit tim nuk rëndësi emri në këtë rast.

Myzejene Selmani – Rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për zgjedhjen e drejtorit ekzekutiv të Institutit Gjeologjik të Kosovës thonë se Ministria i zgjedh dhe i propozon kandidatët, kurse Komisioni Funkcional i emëron.

Dukagjin Shala - MEM – Më parë KPMM-ja e ka bërë një studim për themelimin e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës. Shërbimin Gjeologjik i në fillim e kanë rekomanduar të formohet në kuadër të KPMM-së dhe pas 5 vjetësh të bëhet i pavarur. Këtu e kemi bërë një ndryshim dhe e kemi futur si shërbim brenda Ministrisë, me qëllim që ajo të mos zhvishet nga funksionet dhe pasi të aftësohet të pavarësohet.

*Në votimin për ndryshimin e titullit të amendamentit 62, Instituti Gjeologjik i Kosovës, 1 (një) votë ishte **për** dhe 7 (shtatë) **kundër**. Këtu nuk e ka ngrite dorën asnjëri duke u thirrur ne atë se kemi votuar njëherë.*

Kryetarja – Të kalohet te rekomandimi i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, që drejtori të mos emërohet nga Komisioni Parlamentar, por drejtpërsëdrejti nga Ministria.

*Për ndryshimin e propozuar në Amendamentin 62 nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi votuan: 1 (një) **për** dhe 7 (shtatë) **kundër**.*

Sala Berisha – Shala – Deklaroi se amendamentet e papërkrahura nga Komisioni, të cilat i mbështesin vërejtjet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, do t'i procedojë në seancë plenare, sipas procedurës.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Rekomandim

Kuvendi i Kosovës të miratojë Raportin me amendamente të Projektligjit për miniera dhe minerale nr. 03/L-163.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, nr. 03/L-210

Kryetarja – I njoftoi deputetët së grupi i punës ende nuk e ka hartuar Raportin për këtë Projektligj dhe kërkoi që shqyrtimi të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për

shoqëritë tregtare, nr. 03/L-210.

6. Të ndryshme

a) Rekomandimet e Raportit vjetor të ART-së për vitin 2009

Kryetarja – I njoftoi deputetët së grupi punës i ka hartuar rekomandimet për Raportin vjetor të ART-së për vitin 2009 dhe kërkoi që të diskutohen para miratimit.

Pas debatit Komisioni njëzëri e nxori këtë

Rekomandim

Kuvendi ta miratojë Raportin vjetor të ART-së për vitin 2009 të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit – ART, nr. 196/2/10 të datës 07. 06. 2010 dhe Raportin plotësues nr. 157/2/10 të datës 20. 05. 2010.

b) Plani i Veprimit

Kryetarja – I njoftoi deputetët për Raportin e përmbushjes së Planit të veprimit të Komisionit dhe hapi debat.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti i grupit të punës për përmbushjen e Planit të Veprimit për Kuvendin, për Sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian.

Mbledhja përfundoi në orën 13: 00

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani